

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL MITROVICË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **642-26-5114-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me lëndë djegëse Dru dhe Pelet**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

GRESA COMMERC NTP

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

PIRAN

(Adresa)

Prizren

(Vendi)

(Kodi postar)

+38349611761

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Sahit Bajrami

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

n timer1@hotmail.com

(Adresa elektronike)

10.08.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Autoriteti Kontraktues – Kuvendi Komunal Mitrovicë ka publikuar më 25.06.2026 aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me lëndë djegëse Dru dhe Pelet”, me numër 642-26-5114-1-1-1. Vlera e parashikuar e kontratës është 748,320.00 EUR për periudhë 36 mujore. Aktiviteti është strukturuar si një lot i vetëm, ndërsa përshkrimi i çmimeve përmban rreth 5,600 m³ dru dhe rreth 550 ton pelet.

Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve: 10.08.2026, ora 12:00.

Ankesa ka të bëjë me Njoftimin për Kontratë, Dosjen e Tenderit/Fletën e të Dhënave të Tenderit dhe me Vendimin e Autoritetit Kontraktues për refuzimin si të pabazuar të Kërkesës për Rishqyrtim të OE GRESA COMMERC.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Po. OE GRESA COMMERC ka parashtuar Kërkesë për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues më 03.08.2026 lidhur me të njëjtat tri pretendime ankimore që parashtrohen në këtë ankesë:

- mosndarja e aktivitetit në lote dhe kriteri i referencave prej 1,100,000.00 EUR, me nënshuma të detyrueshme 1,000,000.00 EUR për dru dhe 100,000.00 EUR për pelet, si dhe kërkesa që lideri i konsorciumit të ketë së paku 60% të shumës së kërkuar;
- stoku paraprak prej minimum 2,000 m³ dru dhe 200 ton pelet, përfshirë raportin/vërtetimin e Agjencisë Pyjore për drutë dhe dokumentet e hyrjes në stok për pelet;
- kërkesa për dy kamionë me vinç, “me dyer”, me peshë minimale 26 ton.

Autoriteti Kontraktues e ka REFUZUAR si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim dhe ka vendosur të vazhdojë me Njoftimin për Kontratë dhe dokumentet e tenderit pa i ndryshuar kriteret e kontestuar.

Në vetë Vendimin e AK-së evidentohen mospërputhje faktike: në dispozitiv thuhet se kërkesa është parashtuar më 03.08.2026 në ora 13:29, ndërsa në arsyetim përmendet data 30.07.2026; po ashtu dokumentet e kontestuar referohen me datë 30.06.2026, ndërsa Njoftimi për Kontratë sipas dosjes është publikuar më 25.06.2026. Këto mospërputhje nuk paraqiten si pretendim i ri, por dëshmojnë se arsyetimi i vendimit nuk është ndërtuar mbi një konstatim të saktë dhe të kujdesshëm të gjendjes faktike

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

OE ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me këto dispozita dhe parime:

- Neni 1 i LPP-së – ekonomiciteti, efikasiteti, transparenca dhe përdorimi i drejtë i fondeve publike;
- Neni 7, paragrafët 1, 2, 3 dhe 6 të LPP-së – trajtimi i barabartë, mosdiskriminimi dhe sigurimi i konkurrencës sa më të gjerë;

- Nenet 27 dhe 27/A të LPP-së – përgatitja dhe përmbajtja e dosjes së tenderit;
- Neni 28 i LPP-së – specifikimet teknike dhe ndalimi i kërkesave që krijojnë pengesa të pajustifikuara për konkurrencën;
- Neni 69 i LPP-së – dëshmitë për aftësinë teknike dhe profesionale duhet të jenë relevante, të nevojshme dhe proporcionale me lëndën e kontratës;
- Neni 71 i LPP-së – grupet e operatorëve ekonomikë dhe mbështetja në kapacitetet e anëtarëve;
- Neni 17.7, neni 18 dhe neni 25 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, e ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024;
- Parimi i proporcionalitetit, sipas të cilit kriteret e përzgjedhjes dhe kërkesat teknike duhet të kufizohen në atë që është objektivist e nevojshme për realizimin e kontratës.

Neni 18.1-18.9 i Rregullores Nr. 001/2022 (versioni i konsoliduar me Rregulloren Nr. 002/2024) – AK mund ta ndajë aktivitetin në lote; OE janë të lirë të zgjedhin për cilat lote ofertojnë; AK mund të lejojë shpërbimin e të gjitha loteve ose të kufizojë numrin maksimal të loteve për një OE;

Neni 19.4 dhe 19.5 i Rregullores – specifikimet/kërkesat teknike duhet të jenë të qarta, të sakta, të mos paraqesin kufizime të paarsyeshme dhe, për aq sa është e mundur, të formulohen në aspekt të performancës ose kërkesave funksionale;

Neni 25.13 i Rregullores – AK mund të kërkojë përvojë në kontrata të natyrës së ngjashme me vlerë të caktuar, brenda kufijve ligjorë; kontesti ynë nuk është vetë vlera totale 1,100,000 EUR, por ndarja e ngurtë e kësaj vlere në nën-shuma sipas produktit, e cila përjashton operatorë me përvojë të mjaftueshme të natyrës së ngjashme;

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ankesa parashtrohet kundër Vendimit të AK-së për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim dhe kundër mbajtjes në fuqi të kriterëve të kontestuara. Pretendimet më poshtë janë të njëjta me ato të paraqitura pranë AK-së; në këtë fazë jepen edhe kundër-argumentet ndaj arsytimit që AK ka përdorur për refuzimin e tyre.

PRETENDIMI ANKIMOR 1 – MOSNDARJA NË LOTE DHE KRITERI I REFERENCAVE

Kërkesa e kontestuar 9.1 dhe 9.2 obligon OE që të dëshmojë kontrata të natyrës së ngjashme në vlerë minimum 1,100,000.00 EUR, prej të cilave minimum 1,000,000.00 EUR furnizime me dru dhe minimum 100,000.00 EUR furnizime me pelet; në konsorcium lideri duhet të ketë së paku 60% të shumës së kërkuar.

AK e refuzon pretendimin duke arsyetuar se druri dhe peleti kanë të njëjtin destinim funksional dhe se menaxhimi përmes një kontrate të vetme siguron koordinim më efikas, administrim më të thjeshtë dhe shmang rreziqet nga menaxhimi paralel i dy kontratave. Ky arsyetim nuk e zgjidh çështjen e proporcionalitetit dhe konkurrencës. Fakti që dy produkte shërbejnë si lëndë djegëse nuk do të thotë se tregu i furnizimit është i njëjtë ose se ato duhet domosdoshmërisht të prokurohen së bashku. Druri dhe peleti kanë furnizues/prodhues, njësi matëse, çmime, magazinim, transport dhe shkarkim të ndryshëm. Ato mund të porositen, faturoren dhe menaxhohen veçmas pa cenuar funksionin e ngrohjes.

AK thotë se Ligji nuk e obligon që çdo aktivitet të ndahet në lote. OE nuk pretendon se ekziston detyrim absolut për çdo prokurim. Pretendimi është se, në këtë rast konkret, AK duhet të arsyetojë pse mosndarja është e nevojshme dhe pse përfitimi administrativ i pretenduar peshon më shumë se kufizimi i konkurrencës. Vendimi nuk përmban analizë të tregut, numër të operatorëve të aftë, krahasim të kostove, rrezik konkret nga dy kontrata, apo ndonjë të dhënë që ta provojë këtë.

Arsyetimi i AK-së se operatorët mund të formojnë konsorcium ose të angazhojnë nënkontraktorë nuk e neutralizon kufizimin. Mundësia për bashkim është një e drejtë, jo arsye që AK të hartojë kushte të cilat e detyrojnë një operator të specializuar në njërin produkt të kërkojë partner vetëm për të hyrë në procedurë.

SHEMBULL PRAKTIK I NDARJES NË LOTE

Rregullorja e prokurimit e parashikon shprehimisht këtë mekanizëm. Sipas nenit 18, AK mund ta ndajë aktivitetin në Lote dhe të përcaktojë që një OE mund të shpërblehet për të gjitha Lotet në të cilat renditet i pari. Pra, ndarja e këtij aktiviteti në Loti 1 – Dru dhe Loti 2 – Pelet nuk e detyron Komunën të lidhë patjetër dy marrëdhënie me dy operatorë të ndryshëm. Nëse i njëjti OE paraqet ofertën më të favorshme dhe renditet i pari në të dy lotet, AK mund ta shpërblejë me të dy lotet. Nga aspekti administrativ, AK mund ta menaxhojë furnizimin me të njëjtin operator fitues, ndërsa nga aspekti i konkurrencës u jepet mundësi edhe operatorëve të specializuar vetëm në dru ose vetëm në pelet të ofertojnë.

Kjo strukturë është në favor të AK-së: për secilin produkt krijohet konkurrencë më e gjerë dhe çmimi fitues mund të vijë nga operatorë të ndryshëm. Nëse OE "A" është më i lirë për dru dhe OE "B" është më i lirë për pelet, Komuna përfiton çmimin më të ulët për secilin lot.

Nëse OE "A" është më i lirë në të dy lotet, mund t'i fitojë të dy. Në të dy skenarët ruhet funksionaliteti i furnizimit, ndërsa rritet mundësia reale për kursim të fondeve publike. Veçanërisht problematik mbetet kriteri i referencave. Nëse përvoja me dru dhe me pelet konsiderohet nga AK si 'e natyrës së ngjashme', atëherë imponimi i nën-shumave fikse 1,000,000.00 EUR + 100,000.00 EUR është kontradiktor: një OE mund të ketë mbi 1,100,000.00 EUR përvojë reale në furnizime të ngjashme, por të përjashtohet vetëm pse historiku i tij nuk përputhet me ndarjen numerike të paracaktuar nga AK.

Shembull konkret: një OE mund të ketë 1,100,000.00 EUR referenca të natyrës së ngjashme, p.sh. 900,000.00 EUR furnizime me dru/produkte të ngjashme me bazë drusore dhe 200,000.00 EUR furnizime me pelet. Ky OE e arrin plotësisht vlerën totale të kërkuar prej 1,100,000.00 EUR dhe dëshmon përvojë të konsiderueshme në të dy kategoritë, por megjithatë përjashtohet vetëm sepse i mungojnë 100,000.00 EUR në nën-shumën e paracaktuar për dru. Ky përjashtim nuk buron nga mungesa e kapacitetit real, por vetëm nga formula numerike 1,000,000 + 100,000, dhe si i tillë zvogëlon konkurrencën pa demonstrim se pikërisht kjo ndarje është e domosdoshme për ekzekutimin e kontratës.

Nëse AK e konsideron drurin dhe peletin furnizime të natyrës së ngjashme për qëllim të përvojës, atëherë kriteri duhet të matë përvojën reale të ngjashme dhe jo ta kushtëzojë atë me një raport historik të paracaktuar ndërmjet dy produkteve. Heqja e nën-shumave nuk e ul vlerën totale të kërkuar prej 1,100,000.00 EUR; vetëm e hap konkurrencën për OE që posedojnë të njëjtën vlerë dhe kapacitet, por me strukturë tjetër të referencave.

AK nuk ka dhënë arsyetim konkret as për kërkesën që lideri i konsorciumit të posedojë 60% të shumës së referencave. Kur kapacitetet e grupit vlerësohen bashkërisht dhe anëtarët marrin përgjegjësi sipas rregullave të zbatueshme, një prag i tillë duhet të lidhet me një nevojë konkrete të kontratës, jo të mbetet kusht abstrakt.

Përfundim për pretendimin 1:

Vendimi i AK-së nuk provon se bashkimi në një lot dhe struktura e referencave janë masat më pak kufizuese dhe të nevojshme. Kërkohet që aktiviteti të ndahet në Loti 1 – Furnizim me dru dhe Loti 2 – Furnizim me pelet, me kriteret proporcionale për secilin lot; ose, së paku,

nëse aktiviteti mbahet në një lot, të hiqen nën-shumat fikse dhe të pranohen referenca të natyrës së ngjashme në vlerë të përgjithshme të arsyeshme.

PRETENDIMI ANKIMOR 2 – STOKU PARAPRAK PREJ 2,000 m³ DRU DHE 200 TON PELET

Kërkesa e kontestuar obligon OE të dëshmojë se posedon minimum 2,000 m³ dru dhe 200 ton pelet në stok para dorëzimit të ofertës, me raport/vërtetim nga Agjencia Pyjore e Kosovës për dru dhe dokumente të hyrjes në stok për pelet.

AK e arsyeton kriterin me rëndësinë e vazhdimësisë së ngrohjes, nevojën për reagim të menjëhershëm sipas urdhërblereve dhe me deklarinimin se nga kontratat e mëparshme ka pasur raste kur operatorët pa rezerva të mjaftueshme kanë hasur vështirësi në përmbushjen e obligimeve.

Ky është arsyetim i përgjithshëm, jo provë e proporcionalitetit të sasive 2,000 m³ dhe 200 ton. Vendimi nuk identifikon kontratat e mëparshme, operatorët, urdhërblert, vonesat, sasi të papërmbushura, raportet e menaxherit të kontratës, penaltetet apo ndonjë dokument që të dëshmojë lidhjen mes problemeve të pretenduara dhe pikërisht këtyre dy sasive minimale.

Kontrata është kornizë 36-mujore dhe realizohet sipas urdhërblereve. Për një kontratë të tillë, aftësia relevante është kapaciteti për të mobilizuar mallin brenda afatit kontraktual të dorëzimit. Kërkesa që secili ofertues, para se të dihet fituesi, ta ketë fizikisht në pronësi/depo një pjesë të madhe të furnizimit e zhvendos rrezikun komercial të procedurës të gjithë ofertuesit dhe krijon një barrierë hyrëse që nuk është domosdoshmërisht e lidhur me aftësinë reale të furnizimit.

Për peletin, si Aneks 2 dhe Aneks 3 bashkëngjiten dy oferta reale të tregut të datës 15.07.2026. Njëra ofertë tregon çmim 400.00 EUR/ton me TVSH, ndërsa tjetra 390.00 EUR/ton me TVSH. Kjo e vendos koston e blerjes së 200 ton pelet në rreth 78,000.00–80,000.00 EUR për secilin ofertues, pa përfshirë transportin, magazinimin, sigurimin dhe rrezikun e mosrealizimit të shitjes.

Nëse pesë OE do të dëshironin të konkurronin, vetëm ky kriter do të kërkonte që tregu të mbante 1,000 ton pelet të blerë/deponuar për qëllim tenderimi, edhe pse vetëm një OE do të shpërblehej me kontratë.

Këto oferta e kthejnë argumentin ekonomik nga një vlerësim teorik në provë dokumentare të koston aktualë të tregut. Barra prej afërsisht 80,000 EUR vetëm për peletin është materialisht e rëndësishme dhe duhet të peshohet ndaj masave alternative më pak kufizuese që AK mund të përdorë për të garantuar furnizimin.

Për drurin, vetë natyra e mallit krijon kosto dhe rrezik nga magazinimi, lagështia, kalbja, insektet dhe ulja e vlerës. AK nuk ka analizuar nëse ky impakt është proporcional me qëllimin e garantimit të vazhdimësisë së furnizimit.

Sa i përket vërtetimit të Agjencisë Pyjore, kërkesa për rishqyrtim ka shpjeguar se vërtetimi i stokut kërkon ekzistencën fizike të masës drusore në depo dhe kontroll të sasisë/dokumentacionit. Prejardhja e ligjshme mund të verifikohet për secilën dërgesë konkrete gjatë realizimit të kontratës, përmes fletëpërcjelljeve, damkave, vendimeve mbi prerjen dhe dokumenteve të tjera ligjore.

PROVË KONKRETE – FORMA E VËRTETIMIT TË AGJENCISË PYJORE

Si Aneks 1 bashkëngjitet një vërtetim real i Agjencisë Pyjore të Kosovës, i anonimizuar për të dhënat e palës së tretë. Ky dokument nuk paraqitet për të pretenduar se çdo rast administrativ është identik, por për të provuar natyrën reale të verifikimit që kërkohet kur vërtetohet masa drusore e deponuar.

Nga vetë përmbajtja e vërtetimit rezulton se, pas kërkesës së OE-së, është formuar komision

profesional; komisioni ka dalë në vendin e ngjarjes, në depon e OE-së; ka bërë matjen e masës drusore të deponuar; ka përcaktuar vëllimin e saj; dhe ka verifikuar dokumentacionin përkatës dhe prejardhjen e masës drusore.

Në shembullin e bashkëngjitur është konstatuar rreth 4,349 m hapësinorë / 3,020 m³ dru të deponuar. Kjo provë tregon se kërkesa e DT-së për 2,000 m³ nuk është thjesht “deklarim kapaciteti”, por në praktikë kërkon që masa drusore të jetë fizikisht e deponuar dhe e matshme para ofertimit.

Pikërisht këtu qëndron disproporcionaliteti: OE që ka kontrata furnizimi, burime të ligjshme, kapacitet transportues dhe mundësi reale për ta mobilizuar sasinë menjëherë pas urdhërblërjes mund të përjashtohet vetëm pse nuk e ka bllokuar fizikisht paraprakisht 2,000 m dru në depo para se të dihet fituesi.

AK ka mjete më pak kufizuese për të siguruar furnizimin: marrëveshje ose deklarata furnizimi, kapacitet prodhues/furnizues, plan furnizimi, afat të qartë të dërgesës, sigurim të ekzekutimit, kontroll të dokumenteve për çdo dërgesë dhe verifikim të kapaciteteve/stokut të OE i rekomanduar para lidhjes ose gjatë realizimit të kontratës.

Përfundim për pretendimin 2:

AK nuk e ka dëshmuar domosdoshmërinë e sasive fikse 2,000 m³ dru dhe 200 ton pelet para ofertimit dhe nuk ka analizuar masa më pak kufizuese. Kërkohej heqja e kriterit të stokut paraprak dhe e vërtetimit paraprak si kusht i përgjegjshmërisë së ofertës, duke e zëvendësuar me dëshmi proporcionale të kapacitetit furnizues dhe kontroll të prejardhjes gjatë furnizimit.

PRETENDIMI ANKIMOR 3 – DY KAMIONË ME VINÇ, “ME DYER”, MINIMUM 26 TON

Kërkesa e kontestuar obligon OE të posedojë/sigurojë dy kamionë me vinç, me dyer, të përshtatshëm për transport dhe shkarkim të druve ose peletit, me peshë minimale prej 26 tonësh.

AK e refuzon pretendimin duke thënë se kriteri është përcaktuar pas analizimit të nevojave operative, sasive, numrit të madh të lokacioneve dhe afateve të shkurtra, dhe se kamionët me vinç mundësojnë transport e shkarkim të sigurt, pa angazhime shtesë.

Edhe ky arsyetim mbetet deklarativ. Vendimi nuk jep listën e lokacioneve për të cilat vetëm mjeti 26 ton me vinç është i domosdoshëm, nuk jep sasinë tipike/maksimale të një urdhërblërjeje, afatin minimal të dorëzimit, numrin e dërgesave simultane apo llogaritje të kapacitetit që do të tregonte pse dy mjete 26-tonëshe janë minimumi teknik i nevojshëm. Rezultati që duhet të sigurohet është transporti dhe shkarkimi i mallit brenda afatit dhe në lokacionin e kërkuar. Ky rezultat mund të arrihet me mjete të ndryshme. Një flotë me kamionë më të vegjël mund të bëjë më shumë udhëtime dhe, në zona urbane, rrugë të ngushta ose oborre me qasje të kufizuara, mund të jetë operacionalisht më e përshtatshme se një kamion i rëndë 26 ton.

Peleti zakonisht mund të shkarkohet me rampë hidraulike dhe paletar, forklift ose pajisje ekuivalente; druri mund të shkarkohet me kipi, vinç ose mekanizëm tjetër të përshtatshëm. Kështu, vinçi nuk është domosdoshmërisht e vetmja mënyrë funksionale e shkarkimit. Termi “me dyer” mbetet i paqartë dhe nuk lidhet me një rezultat teknik të matshëm. Gjithashtu, pesha e mjetit 26 ton nuk është e barabartë me kapacitetin real të ngarkesës dhe nuk provon vetvetiu aftësinë për ta përmbushur kontratën.

AK thotë se alternativat operative të OE nuk ia kufizojnë të drejtën AK-së për të caktuar kapacitet minimal. OE nuk e mohon këtë të drejtë; kundërshtimi është se minimumi duhet të jetë objektivisht i lidhur me nevojën dhe i arsyetuar. Kur rezultati mund të arrihet me disa metoda ekuivalente, kriteri duhet të formulohet funksionalisht dhe të pranojë ekuivalencën.

Përfundim për pretendimin 3:

Kërkohet ndryshimi i kriterit në mënyrë që OE të dëshmojë disponueshmërinë e mjeteve të regjistruara për transport dhe të pajisjeve/metodave të përshtatshme për shkarkim, me kapacitet të mjaftueshëm për realizimin e urdhërblërjeve brenda afateve kontraktuale, duke pranuar kamionë me madhësi të ndryshme, rampë hidraulike, kip, vinç, forklift, paletar ose zgjidhje ekuivalente.

VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I VENDIMIT TË AK-së

ÇËSHTJA E AFATIT TË HAPJES SË OFERTAVE DHE EFEKTI I ANKESËS

Pas verifikimit të versionit të konsoliduar të Rregullores Nr. 001/2022, nuk rezulton një rregull që, pas çdo vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim lidhur me dokumentet e tenderit, e detyron AK-në automatikisht ta zgjasë afatin e ofertave për një numër fiks ditësh. Neni 63.1.1(b) parasheh se, pas refuzimit, AK vazhdon më tutje me aktivitetin duke vlerësuar arsyet e refuzimit dhe rrethanat e aktivitetit. Prandaj, këtë çështje nuk e paraqesim si pretendim të ri apo si shkelje të pavarur pa bazë të qartë ligjore.

Megjithatë, me dorëzimin e kësaj anekse në OSHP para hapjes së ofertave, efekti juridik ndryshon: neni 66.1 i Rregullores përcakton pezullimin automatik të aktivitetit me dorëzimin e ankesës, ndërsa neni 24.9 parashikon që gjatë fazës së tenderimit procedura vendoset "në apel" dhe sistemi pamundëson hapjen e ofertave deri në vendim lidhur me ankesën. Për këtë arsye kërkojmë që pezullimi të zbatohet menjëherë dhe të mos procedohet me hapjen/vlerësimin e ofertave deri në vendosjen sipas procedurës ankimore, përveç nëse organi kompetent vendos ndryshe sipas ligjit.

Në të tri pretendimet, AK mbështetet kryesisht në pohime të përgjithshme për 'nevoja reale operative', 'efikasitet', 'vazhdimësi të ngrohjes', 'numër të madh lokacionesh' dhe 'përvojë nga kontratat e mëparshme', por pa i shoqëruar këto pohime me dokumente, të dhëna sasiore ose analizë të alternativave më pak kufizuese. Në këtë mënyrë, vendimi nuk demonstroi se secili kufizim është i nevojshëm dhe proporcional, ndërsa barra ekonomike dhe teknike e kriterëve është e konsiderueshme.

Veç kësaj, arsyetimi i AK-së në disa pika nuk i përgjigjet thelbit të pretendimit. Për shembull, fakti që konsorciumet dhe nënkontraktimi lejohen nuk përgjigjet nëse kriteri bazë kufizon pa nevojë konkurrencën; ndërsa pohimi se AK ka diskrecion për lote ose kapacitete minimale nuk e zëvendëson detyrimin që ky diskrecion të ushtrohet në përputhje me parimet e LPP-së.

ANEKSET / PROVAT DOKUMENTARE

ANEKS 1 – Vërtetim i Agjencisë Pyjore të Kosovës (shembull real i anonimizuar)



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

Agjencia Pyjore e Kosovës
Agencija za Šume Kosova
Kosovo Forest Agency

Ref:DE
Dt:25.08.2025

Bazuar në Ligjin nr.05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjin nr. 08/L-137 për Pyjet, kërkesën me nr. prot. [redacted] e dt. 22.08.2025 parashtruar nga OE [redacted] Sh.p.k me NUI: [redacted], pëfaqësuar nga [redacted] me nr.personal [redacted], raportin e komisionit me nr. prot. 2767 i dt. 25.08.2025, U.d. Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës, lëshon këtë:

V Ë R T E T I M

Me të cilin sipas Raportit të komisionit profesional me nr.prot [redacted] i dt. 25.08.2025 ka dalë në vendin e ngjarjes në depon e OE [redacted] Sh.p.k me NUI: [redacted], pëfaqësuar nga [redacted] me nr.personal [redacted] me adresë rr. [redacted] pas matjes së masës drusore rezultojnë që janë të deponuara dru zjarr me vëllim rreth 4,349.00 m/hapësinorë ose 3.020.00 m³ të llojit Ah, Bung, Qarr dhe Shkozë.

Komisioni ka bërë matjen e masës drusore dhe verifikimin e dokumentacionit përkatës që posedon OE i lartcekur lidhur me prejardhjen e masës drusore të deponuar dhe lidhur me këtë ka konstatuar se ka dokumentacion të mjaftueshëm rreth prejardhjes së masës drusore të cilat i ka të arsyetuar me Fletëpërcjellje të mjaftueshme nga viti 2024 dhe 2025 dhe me damkë pyjore të cilat tregojnë prejardhjen e masës drusore, e cila masë drusore i plotëson të gjitha kriteret ligjore si për nga prejardhja poashtu edhe nga deponimi i saj.

Fidan DEMA
U.d. Drejtor Ekzekutiv i APK-së.

Prova tregon se komisioni profesional ka dalë në depo, ka matur masën drusore të deponuar dhe ka verifikuar dokumentacionin dhe prejardhjen.

ANEKS 2 – Ofertë tregu për pelet, 15.07.2026 – 400.00 EUR/ton

"GNTC Group" SH.A.			Ofertë							
GDS 1 - PRISHTINE			Nr Doc:	2026						
NUI: 810443854 NRTVSH: 330088395			Data:	15.07.2026, Afati i pagesës: 16/07/2026						
Rr. Prishtinë-Gjilan, nr 34, Veternik, 10000 Prishtinë			Blerësi:							
049777721,			NUI:	NRTVSH:						
gds1pr m@gds-ks.com / www.75mall.com			Adresa:							
			Tel.:							

Nr	Shifra	Emertimi Numri Serik	Njesia	Sasia	Çmimi	Zbritje (%)	Ekstra Zbritje	Çmimi Pa Tvsh	Vlera Pa Tvsh	Tvsh (%)	Vlera Me Tvsh
1	A2P	PELET DRURI CLASS A2 12.5 KG	KG	1,000.00	0.440	0.00	9.09	0.37	338.9800	18.00	400.00

Vërejtje:			Vlera pa Zbritje	440.00€
			Zbritje	0.00€
Norma	TVSH	Vlera e tatueshme	Super Zbritje	40.00€
18.00 %	61.02	338.99	Total me Zbritje	400.00€
Për Pagesë:			400.00	



www.75-mall.com
by GNTC group



PCB: 1110011122000197 NLB: 1700200100088831 RBKO: 1501001000880076 TEB: 2011000000129632

Kjo ofertë dokumenton çmim aktual tregu prej 400.00 EUR/ton me TVSH.



"Alfa Globe"Shpk

Nr. Unik: 811410282

Nr. Tvsh: 330447153

Rruga M 2, Veternik-Prishtinë, Kosovë.

Subjekti:

Nr. unik/fiskal:

Nr. biznes/tvsh:

Kontakti:

Adresa:

- KS

Ofertë



Njësia Org.		Data e Porosisë		Data e liferimit		Referenca		Referenti i juaj		Kushtet
Depoja Kryesore		15.07.2026		25.07.2026						NET 10
Nr	Shifra	Përshkrimi	Sasia	Njësia	Çmimi pa Tvsh	Rabati (%)	Tvsh %	Çmimi me rabat	Çmimi shitës	Vlera shitëse
1	122	Pelet druri, për nxemje qendrore, Pakezimi 15/1 Kg	52.000	T	330.508	0.00	18.00	330.508	390.000	20.280.00
Pas kalimit të afatit të pagesës aplikohen ndeshkimet					Vlera pa rabat:					17.186.44 EUR
					Rabat:					0.00 EUR
					Rabat shtesë:					0.00 EUR
					Vlera pa tvsh:					17.186.44 EUR
					Tvsh:					3.093.56 EUR
					Vlera për pagesë:					20.280.00 EUR



Dërgoi:

Kontrolloi:

Pranoi:



Rruga M 2, Veternik-Prishtinë

10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 44 192 422

E-mail: info@alfaglobe-ks.com

Vërejtje: Kjo faturë është e vlefshme pa nënshkrim edhe vullë

© Copyright ALBTRIX 2007 - 2026

Nr. Unik: 811410282

Nr. Fiskal: 811410282

Nr. Tvsh: 330447153

PCB : 11 89 0083530001 03

Swift Code: MBK0XKPRXXX

Iban: XK051189008353000103

TEB : 20 22 0001811641 59

RBKO : 15 01 0900043976 65

Page 1/1

Kjo ofertë dokumenton çmim aktual tregu prej 390.00 EUR/ton me TVSH.

KËRKESA / PETITUMI DREJTUAR OSHP-së

Duke u bazuar në faktet, argumentet dhe dispozitat e mësipërme, OE GRESA COMMERC i propozon OSHP-së që të nxjerrë vendim me të cilin:

VENDIM

1. **APROVOHET** si e bazuar ankesa e OE GRESA COMMERC;
2. **ANULOHET** vendimi i Autoritetit Kontraktues – Kuvendi Komunal Mitrovicë, me të cilin është refuzuar si e pabazuar Kërkesa për Rishqyrtim;
3. **KONSTATOHET** se kriteret e kontestuara të Dosjes së Tenderit nuk janë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme si të nevojshme dhe proporcionale dhe kanë efekt kufizues në konkurrencë;
4. **OBLIGOHET** AK që aktivitetin ta ndajë në Loti 1 – Furnizim me dru dhe Loti 2 – Furnizim me pelet, me kriteret të veçanta e proporcionale; ose, në alternativë, nëse aktiviteti mbahet në një lot, të largohen nën-shumat fikse të referencave 1,000,000.00 EUR dru dhe 100,000.00 EUR pelet dhe të pranohen referenca të natyrës së ngjashme në vlerë të përgjithshme të arsyeshme;
5. **LARGOHET** kërkesa që OE të posedojë paraprakisht në stok minimum 2,000 m³ dru dhe 200 ton pelet dhe të paraqesë vërtetimin paraprak të stokut nga Agjencia Pyjore si kusht para ofertimit;
6. **OBLIGOHET** AK të përdorë dëshmi proporcionale për kapacitetin furnizues dhe ta verifikojë prejardhjen ligjore të druve për sasitë konkrete gjatë realizimit të furnizimit;
7. **NDRYSHOHET** kriteri për dy kamionë me vinç, me dyer, minimum 26 ton, dhe riformulohet si kriter funksional që pranon mjete dhe metoda ekuivalente të transportit/shkarkimit me kapacitet të mjaftueshëm për realizimin e kontratës;
8. **OBLIGOHET** AK që, pas ndryshimit të dokumenteve të tenderit, t'i publikojë korrigjimet në platformën e prokurimit elektronik dhe të caktojë afat të ri/adekuat për dorëzimin e ofertave;
9. **PEZULLOHET** automatikisht aktiviteti i prokurimit me dorëzimin e kësaj ankese, në pajtim me nenin 66.1 të Rregullores; gjatë fazës së tenderimit të zbatohet neni 24.9, duke pamundësuar hapjen e ofertave deri në vendim lidhur me ankesën, përveç nëse pezullimi hiqet me vendim të organit kompetent sipas dispozitave në fuqi.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

OE GRESA COMMERC ka interes të drejtpërdrejtë dhe real për pjesëmarrje në aktivitetin e prokurimit. Kriteret e kontestuara rrisin në mënyrë të panevojshme koston e pjesëmarrjes, kërkojnë bllokim të konsiderueshëm të kapitalit para se të dihet fituesi, kufizojnë mundësinë e përdorimit të kapaciteteve funksionalisht ekuivalente dhe rrezikojnë përjashtimin e OE jo për mungesë të aftësisë reale për furnizim, por për mosplotësim të kërkesave formale të kontestuara. Si pasojë, OE rrezikon humbjen e mundësisë për të konkurruar në mënyrë të barabartë për një kontratë me vlerë të parashikuar 748,320.00 EUR.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.